REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
QENDRA SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL

PROJEKT-VENDIM
NR. 30, DATË 18 /03 /2026

"Për miratimin e përdorimit të transfertës të kushtëzuar akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale dhe bashkëfinancimit të Bashkisë në formën e kontributeve në shërbime apo burime njerezore, për zbatimin e projektit "4 Rrota në Shërbim", viti i peste i zbatimit per vitin 2026, dhe miratimin e buxhetit per kete vit.

Bazuar në ligjin nr.139/2015 për "Veteqeverisjen Vendore", I ndryshuar, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar neni 44,pika b, ligjit Nr.97/2023'' VKB Nr.102 date 26.12.2025 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe programeve buxhetore afatmesem perfundimtare 2026-2028 te Bashkise Devoll", Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", I ndryshuar, ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", I ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje". Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Ligjin Nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar Vendimin nr.823, date 06.12.2006 "Per miratimin e standarteve te Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror, per te Moshuarit ne Qendrat Ditore. VKM nr. 518/2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e sherbimit të organizuar". Shkreses Nr.5055/40 Prot date 29.12.2025, protokolluar me tonen 20 Prot date 05.01.2026 " Mbi financimin e kontributit te kerkuar nga Fondi Social, ne vitin e peste te ofrimit te sherbimit, deri ne 30% te Kostos se sherbimit.Shkreses Nr.580 Prot date 26.01.2026 protokolluar me tonen me Nr.350 Prot date 28.01.2026 per'' Transferimin e Fondeve ne Fondin Social Vendor''. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date 16.02.2026 protokolluar me tonen me Nr.656 Prot date 18.02.2026 mbi akordimin e Fondit Social per vitin 2026. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date. 16.02.2026, protokolluar me tonen me Nr.962 Prot date 11.03.2026, nga Drejtoria Rajonale Korce mbi celjen e fondeve dhe ndarjen e buxhetit sipas zerave qe do te perdoret fondi.

Adresa: BashkiaDevoll, LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

PROPOZOJ:

1. Miratimin e përdorimit të transfertës të kushtëzuar akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale në vlerën 1,572,464 lekë per vitin 2026, për zbatimin e projektit "4 Rrota në Shërbim" viti I peste, i përzgjedhur nga MSHMS për t'u mbështetur për financim për vitin 2026, miratuar dhe akorduar për Bashkinë Devoll.Ky projekt zbatohet per te pestin viti rradhazi me bashkefinancim te Bashkise Devoll ne Burime Njerezore dhe disa shpenzime operative percaktuar ne buxhetin bashkelidhur te Drejtorise se Sherbimit Social miratuar me VKB Nr.102.date 26.12.2025.
2. Ndryshimin e zerit medikamente, percaktuar ne shkresen per Celjen e Fondeve nga Drejtoria Rajonale Korce, nga ''Medikamente'' zevendesohet me zerin ''Aktivitet per Festen e 1 Qershorit'' per femijet me PAK, komunitetit rom/egjiptian dhe femijet te cilet jetojne ne kushte te veshtira ekonomike, te cilet frekuentojne Qendren Shumfunksionale Komunitare Devoll.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, Drejtoria e Sherbimit Social,Qendra Shumefunksionale Komunitare Devoll dhe Burimet Njerëzore.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi:Sekretar i pergjithshem
Adriana Rushitaj
Konfirmoi bazën ligjore: Përgjegjës I Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
Eduard DURO

Adresa: BashkiaDevoll, LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

QENDRA SHUMEFUNKSIONALE KOMUNITARE DEVOLL

Nr.1014 Prot. **Bilisht më, 17.03.2026**

RELACION

"Për miratimin e përdorimit të transfertës të kushtëzuar akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqenies Sociale dhe bashkëfinancimit të Bashkisë në formën e kontributeve në shërbime apo burime njerezore, për zbatimin e projektit "4 Rrota në Shërbim", viti i peste i zbatimit per vitin 2026, dhe miratimin e buxhetit per kete vit.

Ky projekt eshte financuar nga MSHMS ne vleren 1,572,464 leke, bashkia do te ofroje Shumen **4,094,523.57** leke por ne formen e kontributit ne sherbime dhe burime njerezore Pra Bashkia nuk do te ofroje Shumen e siperpermendur ne leke por do te mare pjese ne projekt si bashkefinacuese duke e konvertuar vleren e mesiperme me kontribute ne sherbime sic jane : burime njerezore (stafi) dhe qera ambienti etj dhe disa pajisje kancelari, broshura, fletpalosje etj.

Kjo ndarje sipas kontributit te secilit eshte percaktuar qartesisht edhe ne projekt dhe eshte paraqitur per miratim ne kete forme ne MSHMS gjate aplikimit te projektit.

Përsa i përket buxhetit të Projektit të dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale per periudhen 36- mujore, Bashkia Devoll me shkresën Nr.5055/40 Prot date 29.12.2025, protokolluar me tonen Nr.20 Prot date 05.01.2026 " Mbi financimin e kontributit te kerkuar nga Fondi Social, ne vitin e peste te ofrimit te sherbimit, deri ne 30% te Kostos se sherbimit, ku komisioni I vleresimit te kerkesave per financimin e ofrimit te kujdesit shoqeror ka miratuar vijimin e mbeshtetjes financiare per vitin e peste te ofrimit te sherbimeve. Shkreses Nr.580 Prot date 26.01.2026 protokolluar me tonen me Nr.350 Prot date 28.01.2026 per'' Transferimin e Fondeve ne Fondin Social Vendor''. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date 16.02.2026 protokolluar me tonen me Nr.656 Prot date 18.02.2026 mbi akordimin e Fondit Social per vitin 2026. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date. 16.02.2026, protokolluar me tonen me Nr.962 Prot date 11.03.2026, nga Drejtoria Rajonale Korce mbi celjen e fondeve dhe ndarjen e buxhetit sipas zerave qe do te perdoret fondi.

Ky dokument ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin kategorisë së cilësuar fëmijë dhe familjeve te cilet jetojne ne kushte te veshtira socio-ekonomike.

Sa i përket ndryshimit të zërit "Medikamente", të përcaktuar në shkresën për Çeljen e Fondeve nga Drejtoria Rajonale Korçë, ky zë zëvendësohet me zërin "Aktivitet për Festën e 1 Qershorit" për fëmijët me PAK, fëmijët e komunitetit rom/egjiptian, si dhe fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, të cilët frekuentojnë Qendrën Shumëfunksionale Komunitare Devoll.

Ky zëvendësim në buxhet i përket pikës 2.5.4., duke ruajtur të njëjtën vlerë kostoje.

Ndryshimi është bërë për shkak se medikamentet kanë një rëndësi të veçantë dhe kërkojnë ekspertizë të specializuar për shpërndarjen e tyre. Institucioni ynë nuk disponon ekspertizën e nevojshme për këtë proces, duke marrë në konsideratë edhe faktin që disa medikamente, edhe pse pa recetë mjeku, mund të shkaktojnë reaksione alergjike apo efekte të padëshiruara.

Duke marrë në konsideratë reformën territoriale, kapacitetet e Bashkisë Devoll, mund të identifikohen disa sfida dhe nevoja prioritare në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror në këtë bashki:
Në Bashkinë Devoll verifikohet një staf i kufizuar në Sektorin e Shërbimit Social që mbulojnë dhe garantojnë ofrimin e sherbimeve të kujdesit shoqëror në territor. Mungon Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, ndërsa ekziston Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, dhe Njësia e Mbrojtjes nga Dhuna në Familje dhe Barazisë Gjinore.

Sikundër dhe Plani Social i Bashkisë Devoll ka evidenetuar, nevoja për ofrimin e shërbimeve sociale komunitare të integruara për shtresat më në nevojë, veçanërisht fëmijët dhe adoleshentët sa vjen dhe është në rritje. Tashme Bashkia Devoll duke qene se ka nje qender Shumefunksionale Komunitare e ka shume here me te lehte per te zbatuar projekte me spekter Social.

Në pjesën më të madhe, njësive administrative iu mungon infrastruktura e nevojshme që të sigurojnë shërbimet e kujdesit social në kohë dhe me cilësi. Mungesa e transportit pengon dhënien e përgjigjes në kohë për rastin e identifikuar nga skuadrat e terrenit. Gjithashtu, shumë Njësi Administrative nuk kanë hapësirë të përshtatshme për kryerjen e punës me rastet sipas standardeve të përcaktuara, dhe për pasojë vështirësohet aksesi i fëmiëve dhe adoleshentëve në shërbime të integruara komunitare. Projekt Propozimi ka në qendër të tij shtresat më në nevojë të Bashkisë Devoll, me fokus të veçantë fëmijët dhe adoleshentët. Nëpërmjet kombinimit të njësisë lëvizëse së ofrimit të shërbimeve të integruara me bazë komunitare.

Me një qasje te orientuar gjithashtu drejt fëmijëve dhe mbrojtes së interesit më të lartë të tyre, projekti "4 Rrota në Shërbim" nëpërmjet kombinimit të shërbimeve shoqërore të integruara, dhënies së ndihmës ligjore falas dhe këshillimit psikologjik synon të mbrojë, referojë dhe trajtojë çdo nevojë për shërbime që shtreast më në nevojë kanë.

Projekti do të modelojë ofrimin e Shërbimeve të Lëvizshme për shtresat në nevojë, fokus të veçantë fëmijët dhe adoleshentët në nevojë në territorin e Bashkisë Devoll, duke mundësuar

kështu adresimin dhe përmbushjen e nevojave të tye për shërbime sociale dhe duke I mbrojtur ata nga çdo rast dhune, abuzimi, neglizhimi apo dhe këshillimi dhe mbulim me shërbim Ligjor parësor dhe dytësor pa pagesë.

Objektivat kryesore të projktit janë:

Garantimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve, për t'i mbrojtur ata nga të gjitha format e abuzimit dhe shfrytëzimit dhe të lehtësojnë integrimin e tyre në shoqëri përmes ofrimit të shërbimeve të integuara të kujdesit shoqëror.

Objektivi Specifik 1 Ofrimi i shërbimeve komunitare të integruara dhe mbështetjes së nevojshme për fëmijët dhe adoleshentët viktima të neglizhencës, dhunës, abuzimit, duke respektuar plotësisht parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Objektivi 2 Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit me aktorë publik dhe privat (institucione vendore dhe qendrore, strukturat ligjore, OJQ) për të forcuar mbrojtjen e ofruar për fëmijët viktima të dhunës, abuzimit, fëmijë në situate rruge etj.

Perfundimisht, ky dokument do ti sherbeje te gjithe qytetareve te Bashkise Devoll qe i perkasin kategorive te mesiperme duke nxitur pjesemarjen qytetare, aktivizimin e fëmijëve në jetën publike dhe respektimin e te drejtave te tyre duke nxitur zhvillimin e demokracise dhe respektimin e mëtejshem të të drejtave qytetare.

Bashkengjitur do jetë buxheti per vitin 2026 per projektin"4 Rrota në shërbim", Shkreses Nr.580 Prot date 26.01.2026 protokolluar me tonen me Nr.350 Prot date 28.01.2026 per'' Transferimin e Fondeve ne Fondin Social Vendor''. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date 16.02.2026 protokolluar me tonen me Nr.656 Prot date 18.02.2026 mbi akordimin e Fondit Social per vitin 2026. Shkreses me Nr.217/1 Prot. Date. 16.02.2026, protokolluar me tonen me Nr.962 Prot date 11.03.2026, nga Drejtoria Rajonale Korce mbi celjen e fondeve dhe ndarjen e buxhetit sipas zerave qe do te perdoret fondi.

Ju faleminderit!

DREJTOR I SHERBIMIT SOCIAL

Zerina Sinani

Buxheti I Detajuar
Emërtimi i Propozimit: 4 rrota në shërbim- modelimi i ofrimit të shërbimeve sociale të lëvizshme për shtresat në nevojë të Bashkisë Devoll
Viti I V
Bashkia: Devoll

Aktivitetet e projektit			Planifikimi per vitin 2026						
Nr.	Pershkrimi i Aktivitetit	Njësia (p.sh. pjesë, orë pune / ditë, muaji i personit, muaji, viti, përmbledhje)	Sasia	Paga	Sigurime	Kosto për njësi / Lek	Kosto Total /lek	Kontributi i kërkuar nga Fondi Social	Kontributi i vet I Bashkisë
1.	**Burimet njerëzore**								
1.1 Pagat dhe kostot e lidhura (ju lutemi listoni dhe specifikoni të gjitha pozicionet) 1		muaj	8	50,000.00	8,350.00	58,350.00	466,800.00	312,464.00	154,336.00
1.1.1	1 Psikolog/punonjes social (100 % te kohes)								
1.2 Bashkëfinancimi ne asete, vleres monetare, burime njerezore									
1.2.1	1 Drejtues Projekti (50% te kohes)	muaj	12	73,250.00	12,232.75	85,482.75	1,020,650.00		1,020,650.00
1.2.2	1 Pergjegjes Sherbime Sociale (punonjes social -70% te kohes)	muaj	12	66,416.00	11,091.47	77,507.47	930,089.66		930,089.66
1.2.3	1 Punonjes social Qendra sociale (50% te kohes)	muaj	12	42,390.00	7,079.13	49,469.13	593,629.56		593,629.56
1.2.4	1 Fizioterapist Qendra sociale (50% te kohes)	muaj	12	32,830.00	5,482.61	38,312.61	459,751.32		459,751.32
1.2.5	1 Shofer (50% te kohes)	muaj	12	25,000.00	4,175.00	29,175.00	350,100.00		350,100.00
1.2.6	1 Punonjës Social (50% te kohes)	muaj	11	35,325.00	5,899.28	41,224.28	453,467.03		453,467.03
	Sub total			**325,211.00**	**54,310.24**	**379,521.24**	**4,274,487.57**	**312,464.00**	**3,962,023.57**
2	**Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)**						-		
2.1 Hartimi I protokollit te punes dhe planit te punes vjetor dhe katermujor.		Pako	40			700.00	28,000.00		28,000.00
2.1.1	*Materiale pune (leter etj)*	Cope	9			2,500.00	22,500.00		22,500.00
2.1.2	*Materiale pune (Kancelari)*		5			10,000.00	50,000.00		50,000.00
2.1.3	*Materiale Pune (Tonera)*						-		
2.4 Organizimi i trajnimit 3 ditor për fuqizimin e kapaciteteve të skuadrës së shërbimeve të lëvizshme në bashkëpunim me CRCA/ECPAT Shqipëri.		dite	0			15,000.00	-		
2.4.1	*Trajner*								
2.5 Mbështetja e menaxhimit dhe referimit të rasteve në për ofrimin e shërbimeve shoqërore të integruara. (karburant)		km	2000			25.00	50,000.00	50,000.00	
2.5.1 Veshembathje		persona	100			4,000.00	400,000.00	400,000.00	
2.5.2 Lodra per femije		persona	60			2,000.00	120,000.00	120,000.00	
2.5.3 Pako ushqimore		persona	150			3,000.00	450,000.00	450,000.00	
2.5.3.1Eskursion		persona	0			4,000.00	-	-	
2.5.4 Aktivitet per 1 Qershorin			60			2,000.00	120,000.00	120,000.00	
2.7 Mjete shkollore per femijet e varfer		persona	80			1,500.00	120,000.00	120,000.00	
	Sub total			-	-	**44,725.00**	**1,360,500.00**	**1,260,000.00**	**100,500.00**
3	**Vizibiliteti, botimet, përkthimi etj.**								
3.1 Fletepalosje, broshura mbi rolin e PMF-se ne mbrojtjen e femijeve (komunitet)		cope	800			40.00	32,000.00	-	32,000.00
	Sub total			-	-	**40.00**	**32,000.00**	-	**32,000.00**
	TOTALI			**325,211.00**	**54,310.24**	**424,286.24**	**5,666,987.57**	**1,572,464.00**	**4,094,523.57**
	%							27.7	72.3

Shenim: Duke u bazuar ne piken 1.3 "Te thirrjes per Propozim " buxheti fillestar i vitit 2022 me vlere totale ishte 5.242.500 leke 30% per vitin e peste i takon 1.572.464 leke.

Drejtor i Sherbimit Social
Zerina SINANI

Kryetari I Bashkise
Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL

Nr 20 Prot
Dt 05.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 5033/40 Prot

Tiranë, më 29.12.2025

Lënda: Njoftim

BASHKISË DEVOLL ✓

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në përmbushje të detyrimeve ligjore, për të mundësuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve të ngritura në kuadër të fondit social, ju njofton se:

Komisioni i vlerësimit të kërkesave për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ka miratuar vijimin e mbështetjes financiare, në vitin e pestë të ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror "4 rrota në shërbim" – modelimi i ofrimit të shërbimeve sociale të lëvizshme, për shtresat në nevojë, në bashkinë Devoll, në kuadër të Fondit Social 2026.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të financojë kontributin e kërkuar nga Fondi Social, në vitin e pestë të ofrimit të shërbimit, deri në 30% të kostos së shërbimit, në vlerën **1,572,464 lekë** për vitin 2026.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ka detyrimin ligjor, për të raportuar çdo katër muaj, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në kuadër të bashkëpunimit, kërkohet raportimi në kohë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe të bëhet me dije Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale mbi zbatimin e projektit, si dhe përdorimin e regjistrit elektronik.

Nga ana juaj kërkohet, që të gjitha strukturat përgjegjëse në administrimin tuaj, të kryejnë procesin e vlerësimit dhe referimit të rastit, në ofrimin e këtij shërbimi, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raportimin e të dhënave çdo katër muaj. Mos përdorimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, do të kushtëzojë

vijimin e financimit në kuadër të Fondit Social, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Gjithashtu, Bashkitë duhet të prioritizojnë trajtimin e rasteve të identifikuara dhe referuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Ilda MALOLLARI

Adresa: "Rruga e Kavajës", Tirana, Albania, Tel: +355 22 600 222, www.shendetesia.gov.al

350 Prot
dt. 28.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MIRËQENIEN SOCIALE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 580 Prot.

Tiranë, më 26 01 2026

Lënda: Për transferimin e fondeve në Fondin Social Vendor

BASHKISË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të mekanizmit të Fondit Social dhe në zbatim të Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", rikujton se bashkitë kanë detyrimin për të ngritur dhe siguruar ofrimin e shërbimeve sociale të qëndrueshme për individët dhe grupet në nevojë.

Bazuar në Vendimin nr. 111, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", i ndryshuar me VKM nr. 613/2024, Bashkitë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, kanë detyrimin ligjor të krijojnë dhe administrojnë Fondin Social Vendor si një instrument bashkëfinancues për zhvillimin e shërbimeve sociale.

Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nxit bashkinë të ketë funksional Fondin Social Vendor dhe ta reflektojë këtë angazhim në buxhetin e saj, si pjesë e programit buxhetor 10430 "Përkujdesi social".

Për sa më sipër, dhe në zbatim të Udhëzuesit të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", Bashkia ka detyrimin të përcaktojë dhe të kalojë përqindjen e financimit që i takon, sipas vitit të zbatimit, në kodin e posaçëm për Fondin Social të Bashkisë (V043AAK), në kuadër të programit buxhetor 10430 'Përkujdesi social', për shërbimet e mbështetura rishtazi në kuadër të Fondit Social 2026.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ilda Malile

656 Prot
dt. 18.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQËNIES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
DREJTORIA RAJONALE KORÇË

Nr.217/1 Prot.

Korçë, më 16.02.2026

Lënda: Dërgohet akordimi i fondit social për vitin 2026

DREJTORIA E FINANCËS

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL ✓

BASHKIA DEVOLL

Mbështetur në Ligjin Nr.121/2016 datë 24.11.2016, Neni 47, në VKM Nr.111 datë 23.02.2018, të ndryshuar, si dhe në shkresën e Drejtorisë të Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë me Nr.1188/1 Prot, datë 09.02.2026, ju dërgojmë akordimin e fondit social për institucionin tuaj, për vitin 2026:

ÇELJA FONDI SOCIAL 2026

INSTITUCION	TOTAL ÇELJE
BASHKIA DEVOLL	1,572,464

Merrni masat për njohjen e akordimit të fondit të mësipërm nga ana e Drejtorisë të Financës dhe Drejtorisë të Ndihmës Ekonomike. Gjithashtu të merren masat që nga ana e Drejtorisë të Financës të bëhet sistemimi në planin e buxhetit për vitin 2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Entela Fejzo

"Bulevardi "Rilindasit" (Ish-Mensa e Parkut të Mallrave), Nr.73, Korçë",
nr.tel. 082254825
adresa e-mail: drejtoriarajonalekorce@sherbimisocial.gov.al

Prot 962.
11.03.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MIRËQËNIES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
DREJTORIA RAJONALE KORÇË

Nr. 217/1 Prot.

Korçë, më 16.02.2026

Lënda: Dërgohet akordimi i fondit social për vitin 2026

DREJTORIA E FINANCËS

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA DEVOLL

Mbështetur në Ligjin Nr.121/2016 datë 24.11.2016, Neni 47, në VKM Nr.111 datë 23.02.2018, të ndryshuar, si dhe në shkresën e Drejtorisë të Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë me Nr.1188/1 Prot, datë 09.02.2026, ju dërgojmë akordimin e fondit social për institucionin tuaj, për vitin 2026:

ÇELJA FONDI SOCIAL 2026

INSTITUCION	TOTAL ÇELJE
BASHKIA DEVOLL	1,572,464

Merrni masat për njohjen e akordimit të fondit të mësipërm nga ana e Drejtorisë të Financës dhe Drejtorisë të Ndihmës Ekonomike. Gjithashtu të merren masat që nga ana e Drejtorisë të Financës të bëhet sistemimi në planin e buxhetit për vitin 2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Entela Fejzo

"Bulevardi "Rilindasit" (Ish-Mensa e Parkut të Mallrave), Nr.73, Korçë",
nr.tel. 082254825
adresa e-mail: drejtoriarajonalekorce@sherbimisocial.gov.al